

*Ebu Hjad*

# shejtani

MËNGRAT E MASHTRIMEVE  
TË TIJ



Titulli i librit: **Shejtani, mënyrat e mashtrimeve të tij**

Titulli i origjinalit: **Shaytaan: his ways in misleading**

Autor: **Ebu Ijad**

Përktheu: **Ebu Ensarij Avni ibn Tahir Xhemajli**

Ballina: **Arton Spahiu**

Përmbajtja	
Hyrje.....	4
<hr/>	
Pjesa e parë: Natyra e shejtanit	5
<hr/>	
1. Çfarë është shejtani?.....	5
2. Cili është besimi i Ehli Sunetit në lidhje me shejtanin?.....	6
3. Krijimi i Ademit.....	6
4. Engjëjt i bien në sexhde Ademit por Iblisi refuzon.....	7
5. Ademi, Hava dhe Iblisi përjashtohen nga xheneti dhe dërgohen në tokë.....	8
6. Cili është qëllimi i shejtanit?.....	9
<hr/>	
Pjesa e dytë: Mënyrat dhe mjetet e shejtanit në mashtrimet e tij	10
<hr/>	
1. Nxitja e mosmarrëveshjeve dhe dyshimi i keq.....	10
2. Zbukurimi i bidateve.....	11
3. Teprimi i një çështjeje mbi çështjet e tjera.....	13
Individi.....	13
Komuniteti.....	14
4. Zvarritja dhe thënia “së shpejti”.....	19
5. Përkryerja e rreme.....	20
6. Mos pasja e perceptimit mbi vetveten.....	20
7. Dyshimi.....	22
8. Frika.....	23
<hr/>	
Pjesa e Tretë: Mënyrat e mbrojtës	26
<hr/>	
1. Dituria.....	26
2. Sinqeriteti.....	27
3. Përkujtimi.....	27
4. Kërkimi i strehimit tek Allahu.....	28
5. Leximi i pjesëve të veçanta të Kuranit.....	28
6. Mbajtja e shoqërisë së mirë.....	28
<hr/>	
Bibliografia.....	30
<hr/>	

## بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

Vërtetë, i tërë falënderimi dhe lavdërimi i takon vetëm Allahut. Atë e falënderojmë dhe vetëm prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje tek Allahu nga e keqja e shpitrave dhe veprave tona. Atë që Allahu e udhëzon s'ka kush që e humb dhe atë që Allahu e lë në humbje s'ka kush që e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij.

E në vijim:

Fjala më e mirë është fjala e Allahut dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Punët më të këqija janë bidatet dhe çdo bidat dhe risi e ka vendin në zjarr.

Fatkeqësisht, në kohërat moderne, muslimanët janë më pak të vetëdijshëm rreth ekzistencës së shejtanit dhe kjo për shkak të preokupimit dhe ndjekjeve të kënaqësive të kësaj bote. Ai tashmë nuk konsiderohet dhe nuk kuptohet si kërcënim apo armik. Si pasojë e lënies së mjeteve mbrojtëse nga ana jonë, shejtani ka përfituar plotësisht nga pavëmendshmëria dhe dobësia jonë që të rekrutoj ndihmës dhe ushtri nga mes ynë për ti ndihmuar atij në ligësi dhe shkatërrim. Allahu na ka njoftuar dhe na ka paralajmëruar:

الْمَ أَعْهَدَ إِلَيْكُمْ يَبْنَىءَ آدَمَ أَنْ لَّا تَعْبُدُوا الشَّيْطٰنَ إِنَّهُ لَكُمْ عَدُوٌّ مُّبِينٌ

**“Vallë, a nuk ju kam urdhëruar, o bijtë e Ademit, që të mos e adhuroni djallin, se ai është vërtetë armiku juaj i shpallur?”<sup>1</sup>**

Pjesa në vazhdim është një përmbledhje e shejtanit dhe përfshin një përshkrim të rrugëve dhe mënyrave të cilat ai i përdor për ti larguar njerëzit nga rruga e drejtë e Zotit. Shumica e materialit në këtë punim është përkthyer nga libri i Abdullah al-Khatirit *“Mënyrat e Shejtanit në sulmimin e njerëzve të devotshëm”*. Shpresojmë që Allahu të na bëjë të kemi dobi prej këtij punimi dhe ta bëjë këtë vepër tonën vetëm për hir të Tij dhe të na e llogarisë atë prej veprave të mira në Ditën e Gjykimit.

Ebu Ijad  
Mars 1995

---

<sup>1</sup> Ja Sinë, 60

## Pjesa e Parë: Natyra e shejtanit

### 1. Çfarë është shejtani?

A është ai i vërtetë? Apo vetëm një koncept, një mendim, ide? Apo ai është vetëm një figurë simbolike? Kjo është një pjesë e rëndësishme në akide (besim). Në të vërtetë disa njerëz realitetin e xhindeve e shpjegojnë duke thënë se ato janë si pasojë e mendimeve të këqija dhe sugjerojnë se ata kanë ose janë shpirtra të trupave qiellor.

Besimi në ekzistimin e xhinëve është pjesë e besimit në të padukshmen dhe besimi i asnjë muslimani nuk mund të jetë i plotë derisa ai të pohoj dhe të pranojë çështjet e së padukshmes, pa marr parasysh nëse ky pohim përputhet apo jo me të kuptuarit dhe intelektin e tij. Gjithashtu, realiteti i xhindeve dhe natyrës së tyre të vërtetë është sqaruar me Kuran dhe Sunet.

Allahu i madhërishëm duke na e vetëtuar ekzistencën e xhinëve ka thënë:

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ

“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”<sup>2</sup>

Gjithashtu thotë:

فَلْأَوْحِيْ إِلَىٰ أَنَّهُ اسْمَعَنَّ نَفْرٌ مِّنَ الْجِنِّ فَقَالُوا إِنَّا سَمِعْنَا فُرْعَانَ عَجَبًا

“Thuaj (o Muhamed): Mua më është shpallur se disa prej xhindeve kanë dëgjuar (Kuranin)...”<sup>3</sup>

Dhe i dërguari i Allahut, Muhamedi sal-Allahu alejhi ve selem ka thënë: **“Ka tre lloje të xhindeve. Njëri lloj fluturon në qiell, lloji tjetër është në formën e qeneve dhe gjarpërinjve, dhe lloji i tretë është i vendosur në një vend por udhëton andej-këndej.”**<sup>4</sup>

<sup>2</sup> Dharijat 51:56

<sup>3</sup> Xhin 72:1)

<sup>4</sup> Transmetojnë Behajkiu dhe Tabarani

## 2. Cili është besimi i Ehli Sunetit dhe Xhematit rreth kësaj çështjeje?

Besimi ynë është se shejtani është prej xhindeve. Allahu i Madhërishëm ka thënë:

وَإِذْ قُلْنَا لِلْمَلَائِكَةِ اسْجُدُوا لِآدَمَ فَسَجَدُوا إِلَّا إِبْلِيسَ كَانَ مِنَ الْجِنِّ فَفَسَقَ عَنْ أَمْرِ رَبِّهِ ۗ

“Kur u thamë engjëjve: *“Përluni në sexhde Ademit”, ata u përlun, përveç Iblisit. Ai ishte një nga xhindet dhe nuk iu bind urdhrit të Zotit të vet.*”<sup>5</sup>

Xhindet u krijuan para njerëzve nga një zjarr pa tym.

وَالْجَانَّ خَلَقَهُ مِنْ قَبْلُ مِنْ تَارِ السَّمُومِ

“..kurse para tij kemi krijuar xhindet nga zjarri pa tym.”<sup>6</sup>

Pra xhindet jetonin dhe ekzistonin para njeriut dhe përgjegjësia e tyre është e ngjashme me tonën: të adhurojnë Allahun pa i shoqëruar shok (ortak) Atij. Ata kanë vullnet të lirë ashtu siç kemi edhe ne dhe ata janë përgjegjës për veprimet e tyre ashtu siç jemi edhe ne. Ne nuk e dimë mënyrën se si apo ku kanë jetuar xhindet para krijimit të Ademit, por nëse Allahu nuk ka na njoftuar për këtë për hollësi të tilla, atëherë nuk kanë kurrfarë rëndësie dhe edhe sikur ta dinim kjo nuk do të na sillte dobi. Andaj edhe nuk kemi dobi që të kërkojmë më tepër rreth kësaj çështjeje.

## 3. Krijimi i Ademit

Pas xhindeve, Allahu krijoi Ademin. Ademi ishte krijesa e fundit të cilën e krijoi Allahu. Ibn Kajimi në librin e tij *“El Favaid”* jep dhjetë arsye pse Ademi u krijua i fundit. Do të përmendim disa prej tyre.

**E para:** Që vendi i Ademit dhe pasardhësve të tij të jetë i përgatitur.

**E dyta:** Që ai ( Ademi dhe pasardhësit e tij) të jenë krijesat e fundit të krijuara që u krijuan përveç tij ( qiejt, toka, dielli, hëna, yjet, lumenjtë etj.)

<sup>5</sup> Kehf, 50

<sup>6</sup> El Hixhr, 27

**E treta:** Ngase prodhuesit apo ndërtuesit më të kualifikuar e më të zotët, gjithmonë e plotësojnë veprën e tyre me të përkryer m'u ashtu siç e kanë filluar me bazat dhe shtyllat e saj.

**E katërta:** Ngase Allahu e ka vonuar librin më të mirë të shpallur, të dërguarit dhe komunitetet deri në fundin e kohës (d.m.th Muhamedin, Kuranin dhe umetin e tij) dhe e ka bërë botën tjetër më të mirë se sa këtë botë. Në të njëjtën mënyrë krijesën e Tij më të mirë e krijoi të fundit.

#### 4. Engjëjt i përuan Ademit por Iblisi refuzon

Pas krijimit të Ademit, Allahu kërkoi nga engjëjt dhe xhindet që ti përuleshin Ademit. Domethënia e këtij veprimi ishte bindja e engjëjve dhe xhindeve ndaj Krijuesit të tyre. Nuk e përfshin adhurimin e Ademit ngase origjina për ta bërë një gjë të tillë është prej Allahut të Madhërishëm. Të gjithë ata ranë në sexhde me përjashtim të Iblisit. Kjo histori përmendet shtatë herë në Kuran me tekste të ndryshme. Do ta citojmë një prej tyre nga surja Araf:

وَلَقَدْ خَلَقْنَاكُمْ ثُمَّ صَوَّرْنَاكُمْ ثُمَّ قُلْنَا لِلْمَلَائِكَةِ اسْجُدُوا لِآدَمَ فَسَجَدُوا إِلَّا إِبْلِيسَ لَمْ يَكُن مِّنَ السَّاجِدِينَ (١١) قَالَ مَا مَنَعَكَ أَلَّا تَسْجُدَ إِذْ أَمَرْتُكَ قَالَ أَنَا خَيْرٌ مِّنْهُ خَلَقْتَنِي مِن نَّارٍ وَخَلَقْتَهُ مِن طِينٍ (١٢) قَالَ فَأَهْبِطْ مِثَّهَا فَمَا يَكُونُ لَكَ أَنْ تَتَّكِبَ فِيهَا فَاخْرُجْ إِنَّكَ مِنَ الصَّاغِرِينَ (١٣) قَالَ أَنْظِرْنِي إِلَى يَوْمِ يُبْعَثُونَ (١٤) قَالَ إِنَّكَ مِنَ الْمُنظَرِينَ (١٥) قَالَ فَبِمَا أَغْوَيْتَنِي لَأَقْعُدَنَّ لَهُمْ صِرَاطَكَ الْمُسْتَقِيمَ (١٦) ثُمَّ لَأَتِيَهُمْ مِّن بَيْنِ أَيْدِيهِمْ وَمِنْ خَلْفِهِمْ وَعَنْ أَيْمَانِهِمْ وَعَنْ شَمَائِلِهِمْ وَلَا تَجِدُ أَكْثَرَهُمْ شَاكِرِينَ

“Ne ju krijuam, pastaj ju dhamë formë e u thamë engjëjve: “Përuanini në sexhde Ademit!” Të gjithë iu përuan, përveç Iblisit. Ai nuk ishte nga ata që u përuan. Allahu tha: “Çfarë të pengoi ty të mos përuleshe, kur të urdhërova?”. Ai u përgjigj: “Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijoje nga zjarri, kurse atë e krijoje nga balta.” Allahu i tha: “Atëherë, zbrit prej andej (xhenetit)! Ti nuk ke të drejt të krenohesh në të! Shporru, me të vërtetë, ti je prej të poshtëruarve.” Iblisi tha: “Më jep afat deri në ditën kur do të ringjallen njerëzit!” Allahu i tha:”Ti je nga ata që u është dhënë afati.” Ai tha:”Për shkak se ti më flake tej, unë do t’u zë prit njerëzve në rrugën Tënde të drejtë, e do t’u qasem atyre nga përpara dhe nga

mbrapa, nga e djathta e nga e majta, e kështu Ti do të vëresh se shumica prej tyre nuk janë mirënjohës!<sup>7</sup>”

Pra, Iblisi refuzoi ngase ishte arrogant duke thënë se ai ishte më i mirë se Ademi. Shejtani për mëkatën e tij kërkonte të justifikonte me kaderin e Allahut duke thënë: **Për shkak se Ti më flake tej...**

Pastaj kur e kuptoi se ishte paracaktuar të përfundonte keq, ai kërkoi shtyrjen e afatit që t'i largonte njerëzit nga rruga e drejtë. Ai gjithashtu e bëri të qartë se do t'i sulmonte pasardhësit e Ademit nga çdo rrugë e mundshme, pa marr parasysh mënyrën apo domethënien e saj. Andaj kjo është diçka për të cilën duhet të vetëdijesohemi dhe të kemi kujdes dhe të cilën, në dashtë Allahu do ta sqarojmë në kapitujt e ardhshëm.

## 5. Ademi, Hava dhe Iblisi dëbohen nga xheneti dhe dërgohen në Tokë

Allahu e vendosi Ademin dhe Havën në kopshtin ku shejtani atyre u erdhi duke iu betuar se ishte këshillues i sinqertë dhe i mashtroi ata duke i bërë që ata të mos i bindeshin Zotit të tyre. Allahu atëherë të dy palëve u tha:

قَالَ أَهْبِطَا مَتَّهَا جَمِيعًا بَعْضُكُمْ لِبَعْضٍ عَدُوٌّ فَإِمَّا يَأْتِيَنَّكُمْ مِنِّي هُدًى فَمَنِ اتَّبَعَ هُدَايَ فَلَا يَضِلُّ وَلَا يَشْقَى (١٢٣) وَمَنْ أَعْرَضَ عَن ذِكْرِي فَإِنَّ لَهُ مَعِيشَةً ضَنْكًا وَنَحْشُرُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ أَعْمَى (١٢٤) قَالَ رَبِّ لِمَ حَشَرْتَنِي أَعْمَى وَقَدْ كُنْتُ بَصِيرًا (١٢٥) قَالَ كَذَلِكَ أَتَتْكَ آيَاتُنَا فَنَسِيْتَهَا وَكَذَلِكَ الْيَوْمَ تُنسى (١٢٦)

“Dhe tha:”Zbritni prej xhenetit që të dy (Ademi dhe djalli)! Do të jeni armiq të njeri-tjetrit. Kur t’ju vij udhëzimi nga ana Ime, kush do ta pasoj udhëzimin Tim, as nuk do të humbë, as nuk do të bjerë në mjerim. Kushdo që ia kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër. Ai do të thotë:”O Zoti im, përse më ringjalle të verbër, kur unë kisha shikuar më parë?” Allahu do t’i thotë: “Kështu të erdhën shenjat Tona dhe ti i harrove ato e po kështu sot do të jesh i harruar.”<sup>8</sup>”

Allahu vendosi që Ademi dhe pasardhësit e tij të jetonin në tokë për një kohë të përcaktuar. Armiqtë e tyre, shejtani dhe ushtria e tij, jetojnë se bashku me ta në tokë në mënyrë që t’i venë njerëzit në sprovë dhe largojnë ata nga Rruga e Drejtë e Allahut në të gjitha rrugët e tjera të kundërta me rrugën e Tij, rrugën e

<sup>7</sup> El Araf, 11-17

<sup>8</sup> Ta Ha, 123-126



mëkatit, bidateve, mosbesimit, shirkun, të jenë mosmirënjohës për dhuratat dhe mirësinë e Tij, mosrespektimin e prindërve, të jenë të pa drejt me muslimanët e tjerë, braktisjen e mësimin të fesë, mos mësimin e saj dhe çështje të ngjashme.

## 6. Cili është qëllimi i shejtanit?

Allahu na ka njoftuar se shejtani është një armik i pranuar për njeriun.

﴿أَلَمْ أَعْهَدْ إِلَيْكُمْ يَا بَنِي آدَمَ أَنْ لَّا تَعْبُدُوا الشَّيْطَانَ إِنَّهُ لَكُمْ عَدُوٌّ مُّبِينٌ﴾

**“Vallë, a nuk ju kam urdhëruar o bijtë e Ademit, që të mos e adhuroni djallin, se ai është vërtetë armiku juaj i shpallur?”<sup>9</sup>”**

Allahu nga kujdesi dhe mëshira e Tij e njoftoi robin e Vet për shejtanin, qëllimet e tij, rrugët dhe mënyrat e tij në mënyrë që ta ndihmonte atë kundër tij. Ai, për njërën ndër qëllimet më kryesore të shejtanit ka thënë: **“ Ai vetëm i josh ithtarët e vet, që të bëhen shokë të Zjarrit të përflakur.”**

\* \* \*

---

<sup>9</sup> Ja Sinë, 60

## Pjesa e dytë: Mënyrat dhe mjetet e shejtanit në mashtrimet e tij.

Ka shumë mënyra të cilat shejtani i ka në dispozicion. Kjo ngase ai ka miq dhe aleat nga mesi i njerëzve. Nganjëherë këta miq dhe aleat nuk janë të vetëdijshëm se ata në të vërtetë janë duke punuar për të (kjo i përfshin edhe muslimanët). Shejtani është mjeshtër i planifikimit dhe të gjitha ligësitë në botë ndodhin për shkak të tij, megjithatë, e tërë puna e tij është nën kontrollin, dëshirën dhe urtësinë e Allahut. Në shikimin e Allahut dhe të besimtarëve, puna e shejtanit është mjaftë e dobët:

فَقَاتِلُوا أَوْلِيَاءَ الشَّيْطَانِ إِنَّ كَيْدَ الشَّيْطَانِ كَانَ ضَعِيفًا (٧٦)

**“Luftoni kundër ithtarëve të djallit, sepse vërtetë dinakëria e djallit është e dobët<sup>10</sup>”**

### 1. Nxitja e mosmarrëveshjeve dhe dyshimi i keq

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: *“Vërtetë shejtani ka humbur çdo shpresë që njerëzit e devotshëm ta adhurojnë atë...mirëpo ai do të përpiqet të fus mosmarrëveshje në mesin tuaj<sup>11</sup>.”*

Që do të thotë se ai do të shkaktoj armiqësi dhe mosmarrëveshje në mes tyre, të përhap sprova, t'i bëjë ata të zënë kundër njeri-tjetrit dhe të bëjë që ata ta harrojnë Allahun, Zotin e tyre. Në një tjetër transmetim nga imam Muslimi, i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Shejtani ka humbur çdo shpresë se ata që falin namaz në gadishullin arabik mund ta adhurojnë atë.”*

Gjithashtu pasja e dyshimeve dhe mendimeve të këqija është ves që nxitet nga shejtani. Gruaja e pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, Nëna e besimtarëve, Safija ka thënë: *“I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ve sel-lem) ishte i izoluar në xhami. Shkova ta vizitoja dhe të bisedoja me të gjatë natës. Pastaj u ngrita që të kthehesha në shtëpinë time e ai u ngrit që të më shoqëronte. Dy burra prej ensarëve kaluan aty pranë, Allahu i qoftë i kënaqur me ta- dhe kur e panë të dërguarin e Allahut, ata nxituan. I Dërguari (sal-lAllahu alejhi ve sel-lem) tha: Ejani këtu. Kjo është Safije bint Haj. Të dy ensarët thanë: I lirë nga çdo e metë është Allahu, o i Dërguari i Allahut. Atëherë i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ve sel-lem) tha: Vërtetë se shejtani depërton në trupin e birit të*

<sup>10</sup> En Nisa, 76

<sup>11</sup> Transmeton Muslimi

*Ademit ashtu siç rrjedh gjaku në (damarë) dhe unë u frikësova se ai do tu hidhte dysbime të këqija në zemër e pastaj do thubej kështu apo ashtu.<sup>12</sup>”*

Andaj është e detyrueshme, që kur të qëndrosh në ndonjë vend dhe ndonjë mendim i keq mund të lind kundër teje, t’ua sqarosh atyre që janë duke të të parë apo dëgjuar derisa të mos lesh vend për ndonjë dyshim apo mëdyshje. Dyshimi është njëra nder anët nga ku sulmon shejtani. Ai të bën që vazhdimisht t’i vëzhgosh njerëzit dhe të dëgjosh fjalët e tyre e që pastaj t’i keqinterpretosh dhe të formosh mendim të keq ndaj tyre.

Kjo ndodh edhe në një tjetër mënyrë, ai të bën të dyshosh tek namazi yt gjatë faljes, apo gjatë marrjes abdes. Ai të fut në mendje dyshimin se mbase nuk e ke plotësuar këtë apo atë, se nuk ke lexuar këtë apo atë, përse nuk e bën serish. Pra, shumë njerëz çrregullohen si pasojë e këtyre pëshpëritjeve të shejtanit dhe nuk gjejnë rehati gjatë kryerjes së këtyre veprave të adhurimit.

## **2. Zbukurimi i bidateve.**

Një mënyrë me të cilën shejtani i zbukuron bidatet është duke pëshpëritur: Njerëzit në këtë kohë kanë braktisur dinin e Allahut dhe kthimi në të duket i vështirë. Përse nuk i bëjmë disa vepra adhurimi dhe t’u shtojmë atyre në mënyrë që njerëzit me to të joshen në fe. Ai gjithashtu vjen tek njerëzit dhe u thotë: ”Njerëzit janë larg fesë, mbase nëse sjellim disa hadithe të cilat ua fusin frikën apo ua rrit synimet ata do t’i kthehen fesë.”

Prandaj si rezultat i kësaj ata shpikin hadithe të cilat ia atribuojnë të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Pastaj ata thonë: “Ne nuk gënjejmë kundër të dërguarit, ne gënjejmë për të!!”

Ata gënjejnë kundër të dërguarit dhe shpikin hadithe që t’i frikësojnë njerëzit. Andaj edhe e përshkruajnë Xhehenemin në mënyra të çuditshme dhe të padëgjua dhe ngjashëm këtë e bëjnë edhe për Xhenetin, duke menduar se ata po veprojnë mirë. Natyrisht se shejtani i ka mashtruar ata.

Sufjan Theuri, rahimullah, ka thënë: *“Shejtani është më i kënaqur me bidatin se sa me mëkatit, ngase njeriu mund të pendohet nga mëkatet, kurse bidatxhiu nuk pendohet prej bidatit sepse ai mendon se është diçka e mirë.”*

---

<sup>12</sup> Transmeton Buhariu

Bidatet janë nga veprat e shejtanit dhe ato paraqiten edhe në besim dhe vepër. Kjo është më shkatërruese se sa gjynahu ngase dëmi bie mbi vet fenë dhe bashkimin e muslimanëve. Pasojat e gjynahut nuk e dëmtojnë fenë dhe ato bien vetëm mbi gjynahqarin. Kjo është një nder mënyrat më të fuqishme të shejtanit dhe është përdorur në mënyrë efektive në të gjitha tokat muslimane, secila prej tyre ka bidate të ndryshme unike në adhurim dhe një shumëllojshmëri kontradiktore në veprimin e tyre.

Gjithashtu do vëresh se kjo është mënyra të cilën shejtani e ka përdorur për të futur armiqësi dhe urrejtje në zemrat e muslimanëve dhe kundër njeri-tjetrit. Ai josh disa prej tyre që ta braktisin Sunetin, që të mos jenë më të vendosur dhe të durueshëm në të dhe pastaj të bëjnë ndonjë bidat, ose ndonjë ide apo mendim, apo ndonjë mënyrë të të menduarit e cila kurrë nuk ishte e njohur për sahabet e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem apo për të parët tanë të mirë të këtij umeti. Pastaj njerëzit mbledhen rreth kësaj ideje të re dhe formojnë një grup e fillojnë të pëlqejnë dhe të mos pëlqejnë, të duan dhe të urrejnë sipas themeleve të saj duke bërë që në këtë mënyrë zemrat e tyre të ndahen. Kjo tregon nevojshmerinë e praktikimit të Sunetit në të gjitha çështjet dhe dhënies rëndësi të madhe.

Al Irab bin Sarije, njëri ndër sahabët e Profetit alejhis selam ka thënë:

“I Dërguari i Allahut na mbajti një fjalim prej të cilit zemrat tona u mbushen frikë dhe sytë na u mbushen me lot. Ne i thamë: “O i dërguari i Allahut, duket sikur kjo është këshillë lamtumirëse, andaj na këshillo.” Ai tha: “*U këshilloj t’i frikësoheni Allahut dhe të bindeni edhe nëse një rob bëhet prijësi juaj. Vërtetë se ai që prej jush do jetoj gjatë do të shoh shumë polemika, andaj ju duhet të qëndroni në Sunetin tim dhe sunetin e halifeve të drejtudhëzuar. Kapuni fort me dhëmballë. Kujdes nga çështjet e shpikura, sepse çdo shpikje është bidat, çdo bidat çon në lajthitje dhe çdo lajthitje shpie në zjarr.*”

Prandaj shpikja e ndonjë bidati është gjëja më shkatërruese e këtij umeti dhe është e nevojshme që për secilin musliman të drejtë e të sinqertë të çrrënjos veten, familjen dhe pasardhësit e tij, qofshin ato çështje të besimit, veprave, madje edhe ideve dhe metodologjive të cilat janë në kundërshtim dhe e kundërshtojnë të kuptuarit e sahabëve të të Dërguarit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe të parëve tanë të mirë.

### 3. Teprimi i një çështjeje mbi çështjet e tjera.

Individi

Kjo mund të paraqitet në nivelin individual dhe atë kolektiv.

1. Disa njerëz bëjnë mëkate dhe vepra me të cilat janë të pabindur sepse mendojnë se pasi namazi është shtylla e fesë-dhe është e vërtetë se namazi është një nder shtyllat e fesë dhe gjëja e parë për të cilën do të pyetet robi në Ditën e Gjykimit- atëherë edhe nëse bën mëkate s'ka dem prej tyre. Ai e tepron në çështjen e namazit- e nuk ka dyshim se namazi është vepra më madhështore e fesë, deri në atë masë saqë mendon se namazi do t'ia kompensojë shkurtë-pamsinë dhe veprat e tjera. Kjo është diçka e gabuar. Namazi është pjesë e fesë por nuk e përfshinë tërë fenë.

Njeriu duhet të dijë se namazi i shlyen veprat e këqija dhe e pastron atë nga mëkatet, por kjo nuk duhet të jetë shkak për të vazhduar në mëkate e ta ndiej veten të qetë se namazi i shlyen gjynahet. Kjo gjithashtu është një nder mashtrimet e shejtanit.

2. Një tjetër njeri do të thotë se feja s'është gjë tjetër vetëm se të bashkëveprosh me të tjerët. Gjëja më e rëndësishme është që të sillemi mirë me njerëzit, të mos gënjejme rreth tyre, të mos i mashtrojmë. Ai do besojë deri në atë masë saqë madje as nuk do falet, ngase ai thotë se i dërguari sal-lAllahu alejhi ve selem ka thënë: “Feja është bashkëveprimi me njerëzit.” E vërtetë, por ku është këtu adhurimi i Allahut?

3. Një tjetër do të thotë se gjëja më e rëndësishme është qëllimi i mirë. Mbaje zemrën të pastër. Të mos xhelozosh dhe të mos i urresh njerëzit. Të këtillët lënë anash veprat me të cilat adhurohet Allahu dhe veprat e tjera të mira për të cilat qëllimi i mirë është kusht. Qëllimet e mira asnjëherë nuk i zëvendësojnë veprat e adhurimit të cilat ndërtohen në bazë të tyre (qëllimeve të mira).

4. Një tjetër mënyrë e zakonshme e të mashtruarit të muslimanëve është se ata do të garojnë në memorizimin e Kuranit. Ata përsosin texhvidin (rregullat e leximit të Kuranit) dhe e zbukurojnë atë kur e dëgjon duke e kufizuar veten dhe duke menduar se kjo mjafton tek Allahu, prandaj ata braktisin dhe lënë anash veprat e tjera. Ajo që kërkohet nuk janë vetëm lexuesit dhe memorizuesit, por ata të cilët veprojnë (sipas Kuranit dhe Sunetit).

Gabimet në të gjitha situatat e lartë përmendura nuk ndodhin se njerëzit nuk janë të angazhuar në disa gjëra, por ngase ata e kanë tepruar mbi gjëra të cilat janë të barabarta apo madje edhe më të rëndësishme.

## **Komuniteti**

### **Kjo çështje ndodh edhe në nivelin kolektiv të Umetit.**

1. Një grup do të thotë: gjëja më e rëndësishme është të dimë rreth gjendjes dhe pozitës së muslimanëve dhe armiqve të tyre. Çështjet më të rëndësishme janë çështjet politike. Më nuk jetojmë në kohën e dervishëve. E më këtë mendojnë se çështjet si besimi dhe namazi nuk janë të rëndësishme dhe nuk kanë ndonjë rol në mirëqenien e Umetit në kohën moderne.

Njerëzit e tillë do t'i njohësh menjëherë. Ata do të kenë mësuar gjithçka për komunistet, sekularistet, masonët, socialistet, por kur i pyet rreth një çështje të thjeshtë rreth islamit apo namazit ai nuk mund ta dallojë gjurin nga bërri i tij! Një tjetër karakteristikë është se ata i japin pak rëndësi akidës (besimit) të vërtetë në Allahun, adhurimit të Tij me Teuhid e që të mos i shoqërojnë asgjë në adhurim. Këto janë gjëra të cilat e përcaktojnë mirëqenien e Umetit dhe sigurinë e tij. Dhe këto janë bazat dhe themelet e shtetit Islam. Mirëpo do të shohësh se këta njerëz që thërrasin në gjëra të tilla, i kushtojnë pak rëndësi këtyre çështjeve, shpeshherë duke i lënë anash dhe duke bërë kompromise që u përshtaten atyre.

Mënyra ekonomike dhe politike nuk është mënyra e reformimit. Madje nuk është as imitimi i jobesimtarëve. Rruga e reformimit është bindja dhe falënderimi ndaj Allahut ngase mosmirënjohja ndaj Tij është shkaku kryesor i largimit të ndihmës nga Ai, ashtu siç shihet qartë në Librin e Tij:

وَضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا قَرْيَةً كَانَتْ ءَامِنَةً مُطْمَئِنَّةً يَأْتِيهَا رِزْقُهَا رَغَدًا مِّنْ كُلِّ مَكَانٍ فَكَفَرَتْ بِأَنْعُمِ اللَّهِ فَأَذَاقَهَا اللَّهُ لِبَاسَ الْجُوعِ وَالْخَوْفِ بِمَا كَانُوا يَصْنَعُونَ

**“Allahu e ka bërë shembull qytetin i cili ishte i sigurt dhe i qetë. Atij i arrinin ushqime të bollshme nga të gjitha anët, por pastaj banoret e tij mohuan dhuntitë e Allahut dhe Ai bëri që të shijojnë urinë dhe frikën, si ndëshkim për atë që bënë.<sup>13</sup>”**

<sup>13</sup> En Nahl: 112

Kështu ne humbasim sigurinë dhe ndihmën e Allahut. Muslimanët bëhen mosmirënjohës ndaj Allahut. Ata e nuk e adhurojnë Atë ose ata nuk e adhurojnë në mënyrën e përshkruar dhe të duhur mirëpo vazhdojnë sipas tekeve dhe bidateve të tyre. Ata braktisin Sunetin e të dërguarit, sal-lAllahu aejhi ve selem në jetën dhe shtëpitë e tyre.

Një numër i madh i problemeve që ekzistojnë në ditët tona ekzistonin edhe në kohën e të dërguarit, sal-lAllahu alejhi ve selem- alkooli, prostitucioni, format e palejuara të martesës, luftërat dhe betejat (në mes të fiseve). Megjithatë i dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve selem nuk filloi nga këto probleme. Ai nuk vendosi t'i bashkonte muslimanët dhe tërë Arabinë në politikë të qëndrueshme para se t'i thërriste në dëshminë La ilahe il-la-llah. Ai nuk formoi ndonjë lëvizje që të largonte shtypjen kundër grave e as nuk e ndaloi alkoolin, interesin e çështjet e tjera. Ai nuk e bëri fillimisht të fortë ekonomikisht Arabinë dhe pastaj të shpallte mesazhin e tij.

Kjo refuzon ata të cilët thonë se “fillimisht duhet ndryshuar ambientin para çdo gjëje tjetër. Duhet të imponojmë sistemin islam me anë të forcës”, duke shpërfillur faktin se ende ekziston shirku dhe është i përhapur në Umet dhe ka nevojë që të çrrënjohet apo se njerëzit kanë devijuar nga besimi i pastër. E kur besimi i njeriut të jetë i pastër dhe i drejtë kjo e bënë atë që të jetë i vendosur dhe lejon që njeriu të pranojë me dëshirë dhe lumturi çfarëdo urdhri apo ligji nga Allahu.

Nëse do të imponohej sistemi Islam sot do të ndodhte një revolucion i madh. Nga kush? Nga vet muslimanët! Ngase ata nuk e duan atë. Ata nuk e duan atë sepse zemrat e tyre janë larg Allahut, të mbuluara prej Tij. Ata nuk e njohin Atë dhe nuk dinë se si ti besojnë Atij. Dhe kjo i parandalon ata në zhvillimin e dashurisë ndaj Tij, dashurisë ndaj të dërguarit, sal-lAllahu alejhi ve selem dhe dashurisë ndaj fesë të cilën Allahu e ka zgjedhur për ne. Ata nuk e kuptojnë se çfarë është Teuhidi e çfarë është Shirku. Ata nuk e kuptojnë se çfarë është Sunet e çfarë është bidat, e natyrisht se kjo për shumicën e muslimanëve sot është e vërtetë. Për këtë shkak ata nuk i kuptojnë rregullat, as që kanë zemër të hapur për (t'i mësuar) dhe praktikuar ato.

Sa e mrekullueshme dhe e vërtetë është thënia e Aishës, radiAllahu anha: *“Surja e parë e Kuranit ishte surja e cila përshkruante qartë Xhenetin dhe Xhebenemin. Atëherë kur njerëzit e pranuan Islamin erdhi shpallja rreth hallallit e haramit. Sikur shpallja e parë të kishte qenë “Mos pini alkool” ata do të thonin “Kurrë nuk do heqim dorë”.* Po të ishte

*shpallja e parë “Mos bëni zina” ata do të thonin “Kurrë nuk do heqim dorë nga tradhtia bashkëshortore dhe zinjaja.”<sup>14</sup>”*

Të ndryshosh ambientin është një prej faktorëve por nuk është prej më të rëndësishmëve. Faktori më i rëndësishëm është vendosja e Teuhidit në zemra dhe çrrënjosja e Shirkut prej zemrave. Prania e falënderimit të Allahut dhe mungesa e tij është faktor. Përmirësimi i veprave në pajtim me Sheriatin dhe mungesa e tyre është faktor. Prania e dashurisë dhe urrejtjes për hir të Allahut është faktor, të jesh besnik në kriterin e së vërtetës, të kuptuarit, rruga dhe metodologjia e të parëve tanë të mirë dhe jo grupet apo partitë është faktor. Dhe këtë nuk mund ta arrijmë përveçse duke kërkuar dituri të sigurt dhe autentike nga burimet e sakta dhe duke edukuar vetveten sipas saj. Kjo pastaj do të bënte ndryshimin e dëshiruar dhe të favorshëm në mjedisin rrethues. Ja pra perse pasja e besimit të drejtë në Allahun është thelbësore. Sepse veprimet dhe mosveprimet e njeriut bazohen në bazë të besimit, andaj edhe disa prej selefeve thoshin *“Kushdo që nuk e njeh Zotin e tij ai nuk e njeh vetveten.”*

Kjo është arsyeja se pse nuk është e mundur të bëhet kompromis me ata të cilët kanë nocione dhe besime heretike ndaj Allahut dhe kur përpiqen të sjellin ndryshime dhe reforma nëpërmjet rrugëve të tjera përveç besimit të drejtë në Allahun, ata janë shumë larg nga kjo.

Gjithashtu duhet të kujtojmë se i dërguari i Allahut ishte nën mbikëqyrjen e Allahut të Madhërishtëm dhe gjëja e parë në të cilën ka thirrur i dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, dhe të gjithë të dërguarit, ishte adhurimi i sinqertë dhe i drejtë i Allahut, me besim të drejtë në Të, sipas sunetit të të dërguarit sal-lAllahu alejhi ve selem. I Dërguari, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thirri me vite të tëra në këtë (fjalë) dhe shumë beteja u luftuan për teuhid.

Sahabët, Allahu qoftë i kënaqur me ta, fillimisht pushtuan zemrat e njerëzve me Teuhidin e tyre dhe me mirësjelljen e tyre, pastaj pushtuan vende me xhihadin e tyre dhe bënë që feja e Allahut të jetë mbizotëruese.

2. Ka të tjerë logoja e të cilëve është: gjëja më e rëndësishme është bashkimi. A nuk ka thënë Allahu:

وَأَعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا

---

<sup>14</sup> Transmeton Buhariu



## “ Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut dhe mos u përçani <sup>15</sup>”

Ata këtë e bëjnë çështjen më të rëndësishme, madje edhe nëse përfshin bërjen e kompromisit në besim. Kjo është marrëzi, mosdije dhe mungesë e të kuptuarit. Parimi se duhet të bashkohemi është i saktë, por mënyra është nga kurthet e shejtanit-që t'i harrojmë dallimet e të bashkohemi. Ata harrojnë se pjesa e parë e këtij ajeti është “*Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut..*” që do të thotë: mbahuni pas shpalljes, që është Kurani dhe Suneti.

Pasimi i Kuranit dhe Sunetit nuk bëhet ndryshe veçse sipas të kuptuarit të të parëve tanë të mirë. Në mesin e muslimanëve ka të atillë që kanë probleme me shtyllën e parë të Islamit, besimin e pastër në Allahun. Madje ka edhe të atillë të cilët e kanë nxjerrë veten nga vatha e Islamit si shkak i besimeve të cilat ata i kanë shpikur dhe kanë qëndruar në to-pavarësisht se janë këshilluar dhe janë përmirësuar.

I Madhërishtëm, larg nga çdo e metë është Allahu nga ajo që i përshkruajnë kriminelet dhe ekstremistet të cilët kanë shpikur risi dhe trillime në fenë e Tij. Pastaj janë edhe ata të cilët janë kundër Sunetit të të dërguarit të Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, duke e ngritur intelektin e tyre dhe mënyrën e kuptimit të tyre lart dhe mbi të (Sunetin). Duke mohuar atë që Allahu e shpalli dhe e vërtetoi me gjuhen e të dërguarit të Tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe duke pohuar atë që Allahu e mohoi me gjuhen e të dërguarit të Tij dhe duke u tallur me fenë e Allahut, duke bërë që fjalët dhe kushtet e tyre të shpikura të bëhen shkas i pranimit të thënieve të Allahut dhe të dërguarit të Tij, duke bërë që të mashtrojnë me mendimet, të kuptuarit, trillimet dhe epshet e tyre.

Në të vërtetë ne duhet të bashkohemi mbi themelet e fesë, e që është besimi (akidja) ynë, ne duhet të bashkohemi në vendosjen e Teuhidit dhe çrrënjosjen e Shirkut, duhet të bashkohemi në Sunetin e të dërguarit të Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, dhe në shembullin e selefeve. Ne duhet të duam dhe të urrejmë sipas këtij parimi, të japim dhe refuzojmë, të miqësohemi e armiqësohemi, dhe të zgjedhim shoqërinë tonë sipas këtij parimi. Ky është modeli i duhur për unitet dhe është mënyra se si i dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i bashkoi pasuesit e tij.

3. Ka gjithashtu edhe të cilët janë ekstremist. Këta janë ata që janë kthyer në asketizëm. Duke u shkëputur nga bota dhe duke ikur nga sprovat e saj. Kjo padyshim se në një aspekt është një virtyt, mirëpo nuk është i

---

<sup>15</sup> Ali Imran, 103

tillë kur dështon të përmbush detyrat dhe përgjegjësitë ndaj të tjerëve apo shkakton që njerëzit të mos mbështeten në rrugët dhe mënyrat të cilat Allahu i Madhërishëm ka përcaktuar për robërit e Tij me anë të të cilave ata duhet të kërkojnë ndihmë dhe furnizim.

Ajo që kihet për qëllim këtu është se njerëzit e tillë qëndrojnë në xhami kohë të gjatë dhe e lexojnë Kuranin me orë të tëra e mendojnë se kjo është siguri dhe se mjafton për furnizimin e tyre. Kjo nuk është kështu. Një burrë u soll tek Umeri, radiAllahu anhu. Ai falej me orë të tëra në xhami dhe linte pas dore mjetet e jetesës. Edhe pse njerëzit e lavdëronin atë Umeri tha: “Ky njeri është i pamend”.

Besimi është përdorimi i çdo mënyre sipas mundësive të secilit në mënyrë që të arrihet ajo që dëshirohet (dhe këto gjëra janë ato që Allahu i ka përcaktuar për robërit e Tij-siç janë mësimi i ndonjë zanati apo edukimi etj). Përgjigje e ngjashme u jepet atyre të cilët thonë: Nëse Allahu ka paracaktuar mjetet e jetesës për ne, atëherë cili është qëllimi i duas (pse të lutemi)? Thuhet: Ulu dhe shiko nëse do lindësh fëmijë pa martesë. Ulu dhe shiko nëse të largohet uria nëse nuk ha bukë. Ulu dhe shiko nëse do punësohesh pa ndonjë kualifikim apo mjeshtëri. Me fjalë të tjera Allahu ka paracaktuar rregulla të veçanta me anë të të cilave i rregullon çështjet. Nëse nuk ha nuk e largon dot urinë. Nëse nuk punon dhe nuk përpiqesh nuk do t'i gëzosh të mirat e saj.

Ngjashëm është edhe me lutjen. Allahu ka bërë që duaja (lutja) të jetë një nder mënyrat me anë të së cilës Ai i dhuron mirësi krijesës, e braktisja (lënia) e saj do të thotë se mirëqenia dhe furnizimi i njeriut vihen në rrezik. Sa e mrekullueshme është ajo që ka thënë Ibn Tejmije (rahimullah): “Një ditë një burrë e pyeti atë në xhami: ”O Ebul Abas, a nuk e ka shkruar Allahu për robin e Tij se sa do jetë ai i lumtur dhe i pikëlluar në këtë botë?” Ibn Tejmije u përgjigj: “Natyrisht!” Burri tha: “Atëherë cila është vlera e lutjes ( duasë)?” Ibn Tejmije i tha: “ A nuk beson vëllai im se nëse ti e merr apo jo përgjigjen time kjo tashmë është caktuar?” Ai tha: “Natyrisht, vërtetë se po o shejh!” Ibn Tejmije iu përgjigj: “Atëherë përse më pyet nëse çështja tashmë është e caktuar?”<sup>16</sup>

Kjo tregon se mbështetja dhe kapja pas rrugëve dhe mënyrave të përshkruara nga Sheriati është mbështetja e vërtetë në Allahun dhe mënyra për të arritur dhe realizuar atë që dëshirohet.

---

<sup>16</sup> Fi Wajhit-Tufan e Muhamed Abdulhamid Ahmed fq. 20

**Prandaj, është shumë e rëndësishme të peshohen të gjitha këto çështje sepse një ndër mënyrat me të cilat shejtani sulmon njerëzit është teprimi i një çështjeje deri në dëmtim të çështjeve të rëndësishme së njëjtë apo edhe më të rëndësishme.**

#### **4. Zvarritja dhe thënia “së shpejti”.**

Një ndër mënyrat dhe hilet më të parapëlqyera të shejtanit është t’i bëjë njerëzit të mendojnë dhe të thonë: “do ta bëjë këtë apo atë së shpejti, mbase nesër, jo, javën tjetër e kështu me radhë. Ai bënë që ata t’i vonojnë veprat e tyre duke i bërë të ndjehen të sigurt dhe të lumtur me të tashmen. Disa këtë e kanë quajtur “Pengesja e madhe.”

Dikush do ta vërë studimin si gjënë kryesore për të, andaj dhe thotë: “Kur ti përfundojë studimet, atëherë do të pendohem, do ta mësoj dhe praktikoj fenë time.” Kur ti përfundojë studimet thotë: “Kur të punësohem, atëherë do pendohem.” (Ai punësohet por prapë nuk pendohet). Pastaj thotë: Kur të kryej haxhin, kur të martohem... e kështu me radhë.

Ai vazhdimisht vendos pengesja para vetvetes, duke i vonuar gjërat dhe duke u kënaqur me gjendjen e tij të rehatisë dhe lumturisë. Ai vazhdon kështu derisa ti vije vdekja ndërsa jeta dhe veprat e tij të vërteta ( veprat e mira) ende nuk kanë filluar.

Ajo që shejtani ka për qëllim është t’u pengojë tërësisht nga ndonjë çështje apo së paku t’u vonojë prej saj. Për ata që janë të devotshëm ky është rrezik i madh. Shejtani do vijë dhe dikujt do ti pëshpërisë: Ti nuk je i denjë të studiosh diturinë islame apo ti thërrasësh njerëzit në fe. Prit derisa të kesh studiuar. Mirëpo ne jemi urdhëruar që të tjerëve t’ua mësojmë qoftë edhe kuptimin e një ajeti të vetëm nga Kurani të cilin ne e dimë.

Ibn Kajimi ka thënë: “ Sa e sa njerëz të qëllimit të mirë dhe vendosmërisë shejtani i ka vonuar duke i bërë ata të thonë “Së shpejti”. E sa e sa luftëtarë i ka ndaluar. Mbase ndonjë Fakih ka qëllim t’u kthehet studimeve të tij kurse shejtani do ti thotë: Çlodhu për një orë. Shejtani nuk pushon në zbulimin e dembelisë dhe t’ia bëjë atë të duket e bukur dhe tërheqëse e kështu njeriu vazhdon t’i vonojë veprat e tij. Ai i thotë robit i cili adhuron (Allahun) gjatë natës: Koha nuk ndalet, nata është e gjatë. Derisa arrin mëngjesi e ai ( robi) madje as nuk është falur. Sa e mrekullueshme është ajo që ka thënë poeti:

*Ti fle ndërkohë- mjerë për ty derisa gërbet  
Derisa të vdesësh, atëherë do zgjohesh me të vërtetë*

Dhe merr mësim nga ajo që transmeton Abdurrahman el Maghazili. Ai ka thënë: Në Mekë ishte një grua e mençur e cila ishte e dhënë shumë në adhurim, dhe tek ajo erdhën vëllezërit e saj. Ajo qau pastaj tha: “Vëllezër, ju jeni kënaqësia e syve të mi, vizatoni Ditën e Gjykimit në sytë e zemrave tuaja dhe rrëfejani vetvetes veprat tuaja. Çfarëdo që shpresoni t’u pranohet atë ditë, dëshironi dhe shpresoni në Zotin tuaj që t’ua pranoj dhe tu bekojë e në çfarëdo që keni frikë se atë ditë nuk do t’u pranohet atëherë përmirësojeni sot. Mos jeni të pavëmendshëm ndaj shpirttrave tuaj.<sup>17</sup>”

## **5. Përkryerja e rreme**

Shejtani do vij tek ndonjë njeri dhe do ta bëjë të mendojë se ai është i përkryer. Do t’i thotë atij: Ti je më i mirë se të tjerët. Ti falesh kurse shumica nuk falen. Ti agjëron kurse shumica nuk agjërojnë. Ai e bënë njeriun t’i shikoj të tjerët të cilët janë më të pakët se ai në vepra të mira. Mirëpo kjo është mënyrë me anë të së cilës shejtani dëshiron të të pengoj nga veprimi i veprave të mira.

Gjithashtu shejtani do të të thotë: Veprat e tua do të ndërmjetësojnë për ty; ai pastaj të angazhon me gjëra të cilat janë të lejuara prej të cilave nuk ka as dëm e as dobi, dhe e tërë kjo që ta bëjë robin t’u largohet punëve të mira. Ai do të thotë: Pusho pak, je shumë i zënë, ti je më i mirë se sa të tjerët.

Mirëpo ajo që është e dëshirueshme është e kundërta e kësaj. Shiko filanin i cili agjëron të hënën dhe të enjten, shiko atë që fal namaze vullnetare të cilat ti nuk i fal, shiko ata që kanë fituar ndonjë zanat apo profesion, kurse ti jo. Shiko atë i cili ka mësuar të lexoj Kuranin, kurse ti jo. Shiko filanin i cili përmbush nevojat familjare kurse ti nuk e bënë këtë.

## **6. Mos pasja e perceptimit mbi vetveten**

Shejtani ka dy mënyra për t’ua prishur njerëzve perceptimin ndaj vetvetes.

1. Perceptimi i kënaqësisë dhe mashtrimit. Shejtani e bën njeriun që ai veten ta shikoj me kënaqësi (të jetë i vet kënaqur) e që pastaj ai të goditet me arrogancë dhe mashtrim. Ai pastaj fillon t’i nënçmoj dhe t’i përbuz të

---

<sup>17</sup> Ibn Xheuzije “Sifatus-Safvah” ( 2/278-279)

tjerët. Ai refuzon ta pranojë të vërtetën si pasojë e arrogancës ë tij dhe nuk pranon se është gabim kur gabon. Ai refuzon të ndjek tubimet e dijës që të mësojë nga të tjerët.

Disa njerëz të cilët ndjekin vendet ku ata e lexojnë Kuranin bëjnë gabime. (Dhe për këtë) ata më nuk vijnë në këto ndeja derisa të përmirësojnë gabimet e tyre duke u frikësuar se pozita dhe reputacioni i tyre në sytë e njerëzve të tjerë do dëmtohet. Nëse njeriu i tillë do ndalej dhe do reflektonte për pak kohe se filani i cili është lexues i kualifikuar, dikur ishte në të njëjtën pozitë me të tij, pastaj mësoi në tubime dhe i përmirësoi gabimet e tij. Muxhahidi ka thënë: “Dy lloje njerëzish nuk mësojnë kurrë: mustakbiri (ai që është arrogant) dhe mustahijij (ai që është i turpshëm).<sup>18</sup>”

2. Perceptimi i vetmisë i shoqëruar me modesti. Shejtani do të të thotë: Duhet të jesh modest, kushdo që është modest dhe i thjeshtë atë Allahu e ngrit, ti nuk je njeriu i duhur për këtë çështje. Mirëpo ky njeri është prej atyre njerëzve prej të cilit njerëzit përfitojnë shumë. Qëllimi i shejtanit është ta largojë njeriun nga ajo që mund të arrijë me fuqinë dhe aftësinë e tij. Secili prej nesh ka fuqi dhe aftësi të cilat i janë dhuruar dhe nëse nuk përdoren atëherë ne do të mbahemi në përgjegjësi për to. Personi i tillë i cili i përgjigjet shejtanit ai nuk është modest mirëpo po i ikën përgjegjësisë. Shejtani do të thotë: Lëre këtë revistë për dikë që është më i mirë se ti. Të thërrasësh për tek Allahu është çështje fisnike, lere për ata të pakët që janë më të aftë. Kjo është mënyra se si shejtani vjen dhe i bënë njerëzit të gjykojnë.

Ai po ashtu e bënë njeriun përbuzës dhe vetmitar derisa ai më të mos mendoj as për vete. Ky njeri fillon të thotë: Kush jam unë në krahasim me këtë njeri? Kush jam unë në krahasim me një dijetar? Kështu ai nuk mendon ndryshe vetëm se me intelektin e dijetarit të tij dhe nuk përhap apo bënë publike vetëm se atë që ka thënë shejhu i tij. Parimi është se ne duhet t'i kthehemi Sheriatit. Është e mundur që njeriu që është përballë teje mund të gabojë. Andaj fjalët e tij vlerësohen me fjalët e Allahut dhe të të dërguarit të Tij, sal-lAllahu alejhi ve selem. Çdo gjë që pajton me to pranohet dhe çdo gjë që është në kundërshtim me to, ne e refuzojmë.

---

<sup>18</sup> Transmeton Buhariu

## 7. Dyshimi

Është një tjetër mënyrë e rrezikshme e shejtanit si pasojë e mos vëmendshmërisë së robit dhe ai këtë e bënë në shumë mënyra. Shejtani bën që njeriu të dyshojë në rrugën dhe mënyrën e njeriut që është në hak, në besim dhe vepra të drejta- dikush i cili i mban të drejtat e besimit në Allahun, i zbaton urdhëresat dhe u përmbahet ndalesave të Tij- sidomos kur ai është në mesin e njerëzve të këqij të cilët nuk janë të vendosur dhe kanë devijuar nga Suneti dhe rruga e sahabeve. Shejtani do t'i pëshpëritë dhe do t'i thotë: Të gjithë këta njerëz janë në zjarr, e ti je në xhenet.

E vërteta është se numri i madh nuk duhet krahasuar me numrat e vogël. E vërteta është ajo që është në pajtim me fjalët e Allahut dhe të të dërguarit të Tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Abdullah Ibn Mesudi ka thënë: “Xhemati është çdo gjë që është në pajtim me të vërtetën, edhe nëse je i vetëm.” Pra nuk duhet t'u referohemi shumicës së njerëzve por asaj që është në pajtim me të vërtetën, edhe nëse je i vetëm. Allahu i madhërisëm ka thënë:

وَمَا أَكْثَرُ النَّاسِ وَلَوْ حَرَصْتَ بِمُؤْمِنِينَ (١٠٣)

“Shumica e njerëzve, sado që të dëshirosh ti, nuk janë besimtarë.<sup>19</sup>”

Ai gjithashtu ka thënë:

قُلْ لَّا يَسْتَوِي الْخَبِيثُ وَالطَّيِّبُ وَلَوْ أَعْجَبَكَ كَثْرَةُ الْخَبِيثِ فَاتَّقُوا اللَّهَ يَا أُولِي الْأَلْبَابِ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ (١٠٠)

“ Thuaju: “Nuk barazohet e keqja me të mirën, edhe sikur të të habisë bollëku i së keqes. Prandaj kijeni frikë Allahun, o njerëz me intelekt, me qëllim që të shpëtoni.<sup>20</sup>”

Ka thënë tabi'ini, Naim bin Hamad: “Xhemati është ai që pajton në bindje ndaj Allahut-andaj kur Xhemati të priset atëherë ty të takon të qëndrosh në atë që ishte xhemati para se të devijonte edhe nëse ti je i vetëm (në këtë), atëherë ti je xhemati.”

<sup>19</sup> Jusuf, 103

<sup>20</sup> Maide, 100

Ndërsa Is'shak bin Rahavije, mësuesi i imam Buhariut ka thënë: *“Nëse do t’i pyesje njerëzit injorant ( të paditurit), rreth shumicës do të të thonë shumica e njerëzve. Ata nuk e dinë se xhemati është dijetari i cili u përmbahet transmetimeve të profetit, sal-LAllahu alejhi ve sel-lem dhe rrugës së tij. Andaj kushdo që është me të dhe dijetarin dhe e pason atë, atëherë ai është xhemati.”<sup>21</sup>*

Një shembull i kësaj p.sh është kur njeriu vendos të jap sadaka dhe atë e sheh dikush tjetër. Ky njeri i thotë vetvetes “Nëse më sheh filani, ai do mendojë se këtë po e bëjë sa për t’u dukur-syfaqësi, andaj është më mirë të mos e jap këtë lëmoshë. Megjithatë ne jemi të urdhëruar që ta pastrojmë qëllimin tonë nga syfaqësia dhe jo ta braktisim veprimin. Kjo është dëshira e shejtanit.

Ibrahim bin Ad’ham ( njeri nga tabi’inët) ka thënë: *“I kam parë tridhjetë sahabë të të dërguarit të Allahut ( sal-LAllahu alejhi ve sel-lem), të gjithë frikësoheshin se mos po i bënin veprat e tyre pa sinqeritet.”*

Vërtetë se kërkohet që njeriu t’i kthehet shpirtit dhe gjykimit por qëllimi i kësaj nuk është që ta braktisesh veprën por ta pastrosht njetin dhe t’i shtosh veprat e mira. Ka thënë Harith bin Kajs: *“Kur të vij shejtani ndërkohë që je duke u falur dhe të të thotë: Ti këtë po e bën për t’u dukur, atëherë ti zgjate sexhden.”*

## 8. Frika

Shejtani ka dy mënyra me anë të të cilave bën që njerëzit të frikësohen:

1. Ai bën që ata t’i frikësohen aleateve. Shejtani do ta bëjë njeriun t’i frikësohet ushtrisë së tij, aleateve dhe njerëzve të pabindur e të rebeluar. Ai njeriut i thotë: Ke kujdes prej tyre. Ata kanë fuqi për të cilën ti nuk je i informuar.

Allahu i Madhërishëm ka thënë:

إِنَّمَا دَأْبُكُمُ الشَّيْطَانُ يُخَوِّفُ أَوْلِيَاءَهُ ۗ فَلَا تَخَافُوهُمْ وَخَافُوا اللَّهَ إِن كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ (١٧٥)

**“Në të vërtetë është ai djalli që ju frikëson me ithtarët e vet. Ju mos iu frikësoni atyre, por frikësojuni prej Meje, nëse jeni besimtarë”<sup>22</sup>**

<sup>21</sup> Transmeton Ebu Nu’ajm në “Hiljatul Eulija”

<sup>22</sup> Al’Imran 175

Ai po ashtu i bënë njerëzit që ata t'u frikësohen jobesimtarëve, i bënë të ndjehen inferior dhe u pëshpëritë: Këta njerëz do tallen me fenë tënde, fenë e cila urdhëron prerjen e duarve, fe e cila e detyron femrën të mbulohet e tëra kokë e këmbë. Fe e cila i bënë njerëzit të jenë një muaj të uritur. Kështu njeriu mban të fshehur faktin se ai është musliman dhe nuk shqetësohet që të mësojë sipas fesë së tij dhe e tërë kjo për shkak të thënieve të jobesimtarëve të cilët janë lëndë djegëse të zjarrit të xhehenemit.

Dëgjojeni përgjigjen që i dha Selman al Farisiu (Allahu qoftë i kënaqur më të) një pagani i cili i tha: “Ky profeti juaj u mëson aq shumë saqë ua mëson edhe mënyrat e (veprimeve) në tualet.” Andaj Selmani i tha: “Natyrisht! Ai na ka mësuar që të mos e përdorim dorën e djathtë, të mos kthehemi në drejtim të kiblës, të mos përdorim më pak se tre gurë apo eshtra (për pastrim)!”

Dhe në çfarë ishte kjo përgjigje? Ndërsa sot ne kemi frikë dhe mëdyshje rreth hixhabit, agjërit, rritjes së mjekrës, e gjëra të ngjashme. E tërë kjo është nga veprat e shejtanit dhe është shenjë e dobësisë e cila është e pranishme në zemrat e muslimanëve. I lutemi Allahut të na forcojë zemrat tona dhe ti forcojë e drejtojë ato në fenë e Tij.

## 2. Frika nga varfëria

Allahu i Madhërishtëm thotë:

الشَّيْطَانُ يَعِدُكُمُ الْفَقْرَ وَيَأْمُرُكُم بِالْفَحْشَاءِ ط

**“Djalli ju frikëson me skamje e varfëri dhe ju urdhëron të bëni vepra të pamoralshme.”<sup>23</sup>**

Shejtani thotë: Nëse ti do ta lësh këtë punë, ku do gjesh punë tjetër? Do bëhesh shumë i varfër. Kështu njeriu frikësohet nga varfëria dhe vazhdon ose fillon të veprojë atë që është e ndaluar siç është alkooli. Atë që merr interes e dëgjojmë të thotë: Si do të jetojë? Njerëzit janë pasuruar kurse unë jam i varfër. Shejtani ka folur nëpërmjet tij.

Sa i takon besimtarit të vërtetë para tij janë vazhdimisht fjalët që vijojnë- e a ka fjalë më të mira dhe më qetësuese se këto:

---

<sup>23</sup> El Bekare, 268



مَنْ يَتَّقِ اللَّهَ يَجْعَلْ لَهُ مَخْرَجًا (٢) وَيَرْزُقْهُ مِنْ حَيْثُ لَا يَحْتَسِبُ وَمَنْ يَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ فَهُوَ حَسْبُهُ إِنَّ اللَّهَ بَلِغُ أَمْرِهِ قَدْ جَعَلَ اللَّهُ لِكُلِّ شَيْءٍ قَدْرًا (٣)

“Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'i gjeje rrugëdalje (nga çdo vështirësi), dhe do t'i jap risk prej nga nuk e pret. Allahu e përmbush me siguri premtimin e Tij dhe për çdo gjë ai ka caktuar masë.<sup>24</sup>”

Shejtani bënë që njeriu të merret me mjete që janë haram duke u shfajësuar me varfëri dhe si pasojë e kësaj njeriu bënë shumë kompromise me fenë e tij.

Pra këto janë disa nga mënyrat me të cilat shejtani i mashtron dhe i vë në humbje njerëzit duke u përpjekur që t'i shpie ata në zjarrin përvëlues. Është e udhës që këtë kapitull ta përfundojmë me ajetet vijuese të cilat përshkruajnë skenën Ditën e Gjykimit pasi njerëzit e xhehenemit të kenë hyrë në të. I lutemi Allahut të na ruaj prej tij.

وَقَالَ الشَّيْطَانُ لَمَّا قُضِيَ الْأَمْرُ إِنَّ اللَّهَ وَعَدَكُمْ وَعَدَ الْحَقُّ وَوَعَدْتُكُمْ فَأَخْلَفْتُكُمْ وَمَا كَانَ لِي عَلَيْكُمْ مِنْ سُلْطَانٍ إِلَّا أَنْ دَعَوْتُكُمْ فَاسْتَجَبْتُمْ لِي فَلَا تَلْمُزُونِي وَلَوْمُوا أَنْفُسَكُمْ مَا أَنَا بِمُصْرِخِكُمْ وَمَا أَنْتُمْ بِمُصْرِخِي إِيَّيْ كَفَرْتُمْ بِمَا أَشْرَكْتُمُونِ مِنْ قَبْلُ إِنَّ الظَّالِمِينَ لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ (٢٢)

“Dhe kur të marr fund puna, djalli do të thotë: “Vërtetë, Allahu ju bëri një premtim të vërtetë. Edhe unë ju premtova, por ju mashtrova. Unë nuk kam pasur kurrfarë pushteti mbi ju. Unë thjesht ju thirra e ju m'u përgjigjet. Prandaj, mos më qortoni mua, por qortoni veten! Unë nuk jam shpëtimtari juaj e as ju nuk jeni shpëtimtarët e mi. Unë tani e mohoj që më bëtë ortak me Allahun (në adhurim)”. Vërtetë, keqbërësit do të kenë një dënim të dhembshëm.<sup>25</sup>”

\* \* \*

<sup>24</sup> Et-Talak 2-3

<sup>25</sup> Ibrahim, 22

## Pjesa e Tretë: Mënyrat e mbrojtës

**Ka shumë mënyra me anë të të cilave muslimani mund ta ruaj dhe mbroj veten e tij prej shejtanit. Prej tyre janë:**

### 1. Dituria

Kërkimi i diturisë është detyrë për çdo musliman, mashkull dhe femër. Lloji më i rëndësishëm i diturisë është njohja e Allahut dhe njohja e Teuhidit të Tij. Kjo është ajo që muslimani e mëson para çdo gjëje tjetër. Sa më e madhe të jetë kjo dituri, aq më shumë frikë ka njeriu ndaj Allahut dhe ka më pak gjasë e mundësi që ai ti thyej rregullat e Allahut e të mos i bindet Atij e ta pasojë shejtanin. Allahu ka thënë:

فَاعْلَمْ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ

**“Dije se nuk ka zot tjetër (të denjë për adhurim) përveç Allahut!”**  
Muhamed, 19

Dhe Ai gjithashtu ka thënë:

إِنَّمَا يَخْشَى اللَّهَ مِنْ عِبَادِهِ الْعُلَمَاءُ

**“Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët..”** El Fatir, 28

Dhe i dërguari i Allahut, sal-Allahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Unë jam më i dituri në mesin tuaj rreth Allahut dhe unë i frikësohem më së shumti Atij.<sup>26</sup>”

Pra ai, sal-Allahu alejhi ve sel-lem bëri një lidhje të drejtpërdrejtë në mes diturisë për Allahun dhe frikës ndaj Allahut.

Lloji tjetër i diturisë të cilin muslimani duhet ta kërkojë është dituria rreth veprave të adhurimit të cilat Allahu për të i ka bërë të detyrueshme dhe për

---

<sup>26</sup> Transmeton Buhariu

gjërat të cilat Allahu ka kërkuar që ne t'u përmbahemi. Pra ai vazhdimisht kërkon dhe vepron në bazë të diturisë pa vërejtje. Ai gjithashtu mëson mënyrën se si duhet të bëhet adhurimi duke e ruajtur vetveten me këtë nga rënia në gjëra të shpikura dhe mospranimi i veprave të tij.

Dituria është një mjet i fortë dhe e frikëson shejtanin më tepër se çdo adhurues i zjarritë. Një poet ka thënë:

*Dhe ajo ( dituria) është një shpatë e fuqishme e cila nuk shmang  
Me të i godet pjesët kryesore të atij që të sulmon*

Dituria është pjesë ndërtuese e imanit dhe imani (besimi) është një pengesë e madhe në fytyrën e thirrjeve të shejtanit dhe pëshpëritjeve të tij. Kjo është gjëja e parë të cilën muslimani duhet ta bëjë që ta ruaj veten e tij.

Librat më të mirë për të filluar (kërkimin e diturisë) janë “Bazat e Teuhidit” nga Bilal Filips dhe “Teuhidi kundër Shirkut” nga shejh Muhamed el-Xhibali.

## 2. Sinqeriteti

Shejtani nuk ka kurrfarë kontrolli mbi ata të cilët janë të sinqertë dhe vet ai ka thënë: “ **(Iblisi) tha: “Betohem në madhërinë Tënde se unë do t'i mashtroj (njerëzit) të gjithë, përveç robërve të Tu të sinqertë!”** Sad, 82-83

Andaj përpjekja që të gjitha arritjet dhe orvatjet të jenë të sinqerta dhe vetëm për hir të Allahut, gjithashtu e largon njeriun nga ndjeshmëria ndaj shejtanit dhe planeve të tij. Sinqeriteti është: Pastrimi nga mëkatet e fjalëve dhe veprave nga çdo e metë e dëshirave të shpirtit. Për shembull ndër librat më të mirë rreth sinqeritetit dhe realitetit për të është “*Libri i sinqeritetit*” nga Husein el Avashi.

## 3. Përkujtimi

Të përkujtuarit e Allahut e vendos njeriun nën mbrojtjen e Tij dhe e ruan njeriun nga pëshpëritjet e shejtanit. Allahu la urdhëruar:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اذْكُرُوا اللَّهَ ذِكْرًا كَثِيرًا (٤١)

**“O ju që besuat, përkujtoni All-llahun sa më shpesh.”** El Ahzab, 41

Nga i Dëguari i Allahut sal-Allahu alejhi ve sel-lem janë transmetuar shumë përkujtime, lutje të cilat ai i thoshte në të gjitha momentet dhe situatat dhe për muslimanin është e nevojshme që ta kopjoj rrugën e të dërguarit të Allahut, sal-Allahu alejhi ve selem. Ndër librat më të dobishëm për lutje është libri “Lutje autentike të profetit” nga Valid al Isa.

#### 4. Kërkimi i strehimit tek Allahu

Kur ndokush e sheh se shejtani i pëshpërit atij gjëra të këqija, ai menjëherë duhet të kërkoj mbrojtje dhe strehim tek Allahu duke thënë “Eudhubi-lahi mine shejtani-rraxhim” – Kërkoj mbrojtje tek Allahu nga djalli i mallkuar. Allahu i Madhërishëm ka thënë: **“Nëse djalli përpiket të të shtyjë drejt së keqes, kërko strehim tek Allahu, se vërtetë, Ai dëgjon dhe di gjithçka.”** (El Araf 7:200)

#### 5. Leximi i pjesëve të veçanta të Kuranit

Leximi i pjesëve të Kuranit me dituri dhe duke ua ditur kuptimin dhe me bindje të fortë e të qëndrueshme se ato e mbrojnë njeriun nga shejtani dhe janë transmetuar nga i dërguari i Allahut sal-Allahu alejhi ve selem, në mënyrë autentike.

-Ajeti kursija ( Ajetet e Fronit ), surja Bekare 2: 255

-Dy ajetet e fundit të surës Bekare ( 2: 285-286)

- Leximi i surës Bekare e pengon shejtanin që të hyjë në shtëpi.

-Leximi i Muadhetanës, dy sureve të fundit të Kuranit (113-114)

Thirrja e ezanit gjithashtu e zmbrops shejtanin dhe punët e tij. E bënë që ai t'i fus gishtat në vesh dhe të ikën me vrap.

#### 6. Mbajtja e shoqërisë së mirë

Është thelbësore që të mbahet shoqëria e duhur ngase shejtani nuk dështon të të vërë në lajthitje dhe të të mashtroj në raport me shoqërinë që ke. I Dërguari i Allahut sal-Allahu alejhi ve selem ka thënë: *“Shembulli i ndejës me njerëz të mirë dhe ndejës me njerëz të këqij është sikurse shitorja e miskut (parfumeria) dhe farkëtorja. Shtësi i miskut ose të jep (të eros) ose të shet, ose së paku prej tij kundërmon erë e këndshme. Kurse farkëtari ose t'i djeg teshat, ose prej tij do të vjen erë e pakëndshme (nga thëngjilli)”*. (Transmeton Buhariu).

I Dërguari i Allahut, sal-Allahu alejhi ve sel-lem gjithashtu ka thënë: “*Mos u bëj shok i askujt përveç besimtarit.*” (Tranmeton Ebu Daudi)

Poeti ka folur të vërtetën kur ka thënë:

*Zgjedh nga mesi i njerëzve, atë që të udhëzon,  
Vërtetë, me anë të shokut njeriu udhëzon vetveten  
Dhe shoqërimi me të këqinjët është verbëri dhe sëmundje  
E rrit sëmundjen e zemrës me sëmundje  
Andaj nëse je pasues i Sunetit  
Shmangu nga shoqëria e keqe.*

Andaj të jesh i përkushtuar në mbajtjen e shoqërisë së mirë dhe qendro vetëm me muslimanët, me ata të cilët i frikësohen Allahut dhe të cilët orvaten ta adhurojnë Atë. Nëse e bën këtë, kurrë nuk do të jesh në gjendje t'i numërosh mirësitë të cilat do të të jepen, dhe me ndihmën e Allahut qëndron suksesi.

---

Pra këto janë disa nga mënyrat e mbrojtës nga shejtani i mallkuar, atë i cili bëri që prindërit tanë të dëboheshin nga xheneti dhe i cili ka premtuar se do t'i largojë njerëzit nga rruga e drejtë me anë të tradhtisë dhe mashtrimeve të tij. Allahu na ruajt prej tij dhe prej ushtrisë së tij duke na bërë prej atyre që janë të sinqertë, që e përkujtojnë Atë, dhe të cilët tek Ai kthehen me pendim. Amin.

Të gjitha falënderimet dhe lavdërimet i takojnë vetëm Allahut. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi profetin Muhamed, sal-Allahu alejhi ve sel-lem pas të cilit më nuk ka profet.

Bibliografia.

1. **Kurani**
2. **Sahihu i Buhariut**
3. **Sahihu i Muslimit**
4. **“El Favaid”** nga Ibn Kajimi
5. **“Madakhil ush-Shejtan alas-Salihin”** nga Abdullah el Khatir
6. **“Madarixhus Salikin”** nga Ibn Kajimi
7. **“Eseja e Ibn Tejmijës rreth xhindeve”** nga Ebu Eminah Bilal Filips